Nga e majta: Kadire Rexha (Praktikante) dhe Agron Kastrati (Zyrtar Ligjor).

Intervistë me: **AGRON KASTRATI**
nga: **KADIRE REXHA dhe SINAN MORINA**

"Po të mos ishte zyra jonë mobile në Malishevë, palët tona do të përballeshin me shumë pengesa në qasjen në drejtësi. Palet tona janë të varfra dhe ne jemi e vetmja adresë..."

Ne ishim me fat që patëm mundësinë e kryerjes së praktikes në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas (ANJF) në zyrën e tyre mobile në Malishevë. Ne kemi punuar përkrah Agron Kastratit, për gati një vit dhe si rezultat, jemi më të vetëdijshëm për fisnikërinë e punës dhe sfidat që vijnë me të. Prandaj, kur aktiviteti i USAID-it Drejtësia Vlen na u afrua me projektin e

Agron Kastrati - Zyrtar Ligjor

"të dëgjuaritë": Një Intervistë me profesionistë, ne ju përvishëm punës. Ne dëshironim të paraqisnim profesionistë frymëzues si Agroni tek juristet e tjerë të rinj. Ai është i përkushtuar në punën dhe në kontributin e tij në komunitet pavarësisht sfidave, e veçanërisht gjatë kufizimeve të COVID-19. Prandaj, ne ishim të nderuar të zhvillonim një intervistë me të dhe të ndanim historinë e tij më poshtë.

1. Pse vendosët të beheni jurist?

Arsyeja kryesore që vendosa të bëhem jurist ishte që t'u shërbeja qytetarëve të vendit dhe të kontriboja në fushën e drejtësisë, për të cilën vendi ynë ka shumë nevojë.

2. Pse vendosët të punonit për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas?

Pas përfundimit të studimeve Master si dhe shumë trajnimeve të ndryshme, angazhimi im ishte të gjeja një punë rreth sistemit të drejtësisë. Prandaj, pasi kalova një proces konkurrues, unë u zgjodha për pozicionin e zyrtarit ligjor në ANJF. E pranova këtë punë me shumë përgjegjësi që të punoj dhe të kontriboj për ANJF-në dhe për ndërtimin e karrierës sime. Puna me këtë komunitet është një punë shumë e dëshiruar.

3. Çfarë mendoni se do të arrini duke punuar në ANJF?

Puna si zyrtar ligjor në ANJF do të me ndihmojë shumë në karrierën time. Kjo përvojë do të më ndihmojë të kaloj provimin e jurisprudencës në të ardhmen, gjë që do të më mundësojë më vonë të futem në një nga Profesionet e Lira juridike.

4. Si është një ditë tipike pune për ju?

Si të gjithë zyrtarët e tjerë institucionalë, ne fillojmë punën në orën 8 të mëngjesit dhe përfundojmë në orën 4 pasdite. Së pari kontrollojmë e-mailat dhe më pas vazhdojmë me detyrat e përditshme, kryesisht duke punuar me palë dhe duke hartuar shkresa ligjore, bazuar në përparësitë. Ndonjëherë ne kemi angazhime edhe jashtë zyrës, ku marrim pjesë në takime dhe ngjarje të ndryshme me përfaqësues të institucioneve të nivelit lokal.

Agroni, Kadirja dhe Sinani në zyrën mobile në Malishevë

5. Sa jeni i kënaqur me punën tuaj? Si është puna me qytetarët?

Deri më tani, unë jam shumë i kënaqur me punën time. Unë jam shumë i kënaqur me menaxhmentin dhe kolegët. Ata janë gjithmonë të gatshëm të më mbështesin dhe ndihmojnë në zbatimin e detyrave të mia të përditshme. Natyrisht, pjesa më e mirë e punës është të punosh me palët dhe t'i ndihmosh ata në çështjet e tyre. Unë pata mundësinë të ndihmoj një numër të konsiderueshëm të qytetarëve duke u ofruar këshilla dhe përfaqësim ligjor. Po të mos ishte zyra jonë mobile në Malishevë, palët tona do të përballeshin me shumë pengesa në qasjen në drejtësi. Palët tona janë të varfra dhe ne jemi e vetmja adresë që u mbetet atyre për të kërkuar mbështetje. Prandaj, unë gjej gëzim dhe përmbushje personale në çdo rast që mund të ndihmoj.

6. Cilat aftësi profesionale janë të nevojshme për të pasur sukses në punën tuaj?

Përveç arsimit dhe përvojës së mëparshme të punës, një zyrtar i ANJF-së duhet të ketë aftësi personale dhe ndërpersonale. Të jetë i hapur për publikun dhe palët, të jetë komunikues, të lexojë me kujdes dhe kuptojë natyrën e çështjes; analizojë dhe krahasojë rastet dhe të merr parasysh rrethanat specifike të secilës palë.

7. Sa e vështirë ka qenë të punoni gjatë pandemisë COVID-19, si i keni përfunduar punët?

Gjatë kësaj kohe, ka qenë e vështirë sepse nuk ka qenë një situatë normale për të kryer punën tonë me palët. Por bazuar në vendimet e ANJF-së dhe institucioneve të tjera, ne kemi kaluar në punën permes internetit. Ne i kemi ndihmuar palët tona në rastet e tyre përmes emailave dhe telefonatave. Për më tepër, ANJF së bashku me akterët e saj bashkëpunues USAID dhe GIZ, ka organizuar trajnime dhe takime online, të cilat ne i kemi mbajtur me shumë vullnet dhe kuriozitet.

8. A ju ka ndihmuar puna juaj si zyrtar ligjor për ndihmë juridike në ANJF të rriteni profesionalisht?

Sigurisht. Nga pikëpamja profesionale, përvoja ime me ANJF-në ka ndikuar ndjeshëm në zhvillimin tim. Kam pasur mundësi të ndjek trajnime që më mundësuan të avancoj njohuritë e mia për ligjin. Për më tepër, për shkak të mundësive që kam pasur për të marrë pjesë në ngjarje dhe mundësive për t'u takuar me përfaqësues të ndryshëm institucional, unë kam zhvilluar aftësitë e mia ndërpersonale.

Në lidhje me këtë intervistë: *Kjo intervistë u zhvillua nga praktikantë të aktivitetit Drejtësia Vlen si pjesë e projektit "te dëgjimit": Intervistë me profesionistë ligjor. Aktiviteti Drejtësia Vlen është një projekt tre vjeçar për të përmirësuar qasjen në drejtësi për të gjithë, përfshirë grupet e disfavorizuara dhe të margjinalizuara, duke forcuar institucionet, akterët dhe proceset për ofrimin e shërbimeve dhe informacionit ligjor.*